


03/06/2024

“BUQETË LULESH SHPIRTËRORE”



Sapo ka dalë në qarkullim Vëllimi i Dytë i librit “BUQETË LULESH SHPIRTËRORE” (2010-2011) me predikime të Mitropolitit të Beratit, Vlorës dhe Kaninës, Hirësi Ignatit.

Libri përmban predikime të Pashkës, të Krishtlindjes, të të dielave dhe të kremteve të mëdha zotërore, hyjlindësore dhe të disa shenjtorëve, të kumtuara përgjatë viteve 2010-2011.

Librin mund ta gjeni në libraritë e kishave kryesore të zonave të dioqezave të vendit.

"Prandaj edhe ne, të rrethuar prej një reje kaq të madhe dëshmitarësh, le të hedhim tej çdo barrë dhe mëkatin që na pushton lehtë, dhe me durim le të sulemi në rrugën që është përpara nesh..."


(Hebrenjve 12:1)

Poshtë kësaj "reje" të heronjve të besimit, thirremi edhe ne të imitojmë jetën e tërëndritshme të shenjtorëve. Epoka jonë ka nevojë jo aq shumë për njerëz të urtë sesa për shenjtorë. Për kryefamiljarë të nderuar dhe për profesionistë të ndershëm, për shkencëtarë të shenjtë dhe teknikë besnikë, për priftërinj oshënarë, për pedagogë të virtytshëm, me një fjalë, për të krishterë të gjallë dhe të vërtetë; të mbushur me mirësi, drejtësi dhe dashuri; dhe, me vështrimin të drejtuar tek Udhëheqësi i besimit tonë, Jisu Krishti, të marrim prej Tij guxim e fuqi të pamposhtur.

*(Nga predikimi mbajtur të Dielën
e Gjithë Shenjtorëve, 30.05.2010)*

† IGNATI

Mitropolit i Beratit, Vlorës dhe Kaninës



"Koni predikoni në të gjitha
kombet... duke u mësuar atyre
të gjitha gjërat që unë ju kam
urdhëruar" (Mattheu 28:19-20)

Buqetë lulësh shpirtërore

II

PREDIKIME 2010-2011

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)